



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 4500/g Prot.

Pogradec, më 23.12.2025

VENDIM

Nr. 129, datë 23.12.2025

**PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z.NEXHIP PIPERI, LAGJA 5,
BASHKIA POGRADEC, PËR SHKAK TE DENTIMIT TE BANESES NGA RENIA
E ZJARRIT.**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, "Për Veteqeverisjen Vendore", të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të z Nexhip Piperi, për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit në datën 27.10.2025.
2. Miratimin e dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Nexhip Piperi ndihmën emergjente në vlerën prej **250481Lek.**
nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Nj.A, Sherbimeve dhe Titujve të

Pronesise, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkisë Pogradec.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Albana PRIFTI

1.Miratuar me 25 vota

2.Vota Pro 25

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 23.12.2025

